



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Fakulteti: Bujqësisë dhe Veterinarisë

Departamenti: Agroekonomi

Programi: Ekonomi e Bujqësisë dhe Ushqimit

NJOFTIM

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se:

Ekzemplari (drafti) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja Yllka Dibrani, me titull:

“Analizimi i zinxhirit të vlerës në sektorin e verës nga fermeri deri te konsumatori” ndodhet në diskutim publik 7 ditë, nga datë 16 deri me datë 22.09.2024.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. Asis. Dr. Iliriana Miftari – kryetar,
2. Prof. Dr. Arben Musliu – anëtar,
3. Prof. Dr. Bedri Dragusha – anëtar.

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte te udhëheqësi shkencor i temës Prof. Asis. Dr. Iliriana Miftari, përmes e-mail adresës iliriana.miftari@uni-pr.edu.

Për të pasur një informacion paraprak, më poshtë gjeni një përmbledhje të shkurtër të temës në fjalë.

Çdo sygjërim i juaji mund të jetë një pasurim i punës tonë!

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË
DEPARTAMENTI AGROEKONOMI
PROGRAMI EKONOMI E BUJQËSISË DHE USHQIMIT



Tema:

“Analizimi i zinxhirit të vlerës në sektorin e verës nga fermeri deri te konsumatori”

Mentor:

Prof. Asis. Dr. Iliriana Miftari

Kandidati:

Bsc. Yllka Dibrani

Prishtinë, 2024

PËRMBLEDHJE

Ky punim trajton analizimin e zinxhirit të vlerës në sektorin e verës në Kosovë, duke filluar nga fermeri deri te konsumatori. Përmes një shqyrtimi të hollësishëm të praktikave aktuale të kultivimit, përpunimit, tregtimit dhe konsumit, punimi identifikon sfidat dhe mundësitë për përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë në prodhimin e verës. Një fokus i veçantë i është dhënë përdorimit të teknologjive të reja dhe inovacionit në sektorin e vreshtarisë, si dhe në rolin edukimit të fermerëve për praktikat moderne të bujqësisë që mund të rrisin rendimentin dhe cilësinë e rrushit.

Në këtë kontekst, është analizuar ndikimi i përpunimit të rrushit në cilësinë e verës dhe nevoja për investime në teknologji të avancuara të përpunimit. Gjithashtu, infrastruktura e transportit është vlerësuar si një faktor kyç për ruajtjen e cilësisë së produktit deri sa të arrijë te konsumatori final. Punimi shqyrton edhe rolin e distributorëve dhe strategjive të marketingut në promovimin dhe tregtimin e verës vendore.

Bazuar në rezultatet e analizës, punimi ofron rekomandime konkrete për përmirësimin e zinxhirit të vlerës. Këto përfshijnë investime në edukimin dhe trajnimin e fermerëve, përmirësimin e infrastrukturës së transportit, zhvillimin e strategjive efektive të marketingut dhe edukimin e konsumatorëve për të rritur ndërgjegjësimin dhe besimin në verën vendore. Gjithashtu, qeveria është rekomanduar të ofrojë subvencione dhe mbështetje financiare për fermerët, si dhe të nxisë bashkëpunimin ndërmjet aktorëve të ndryshëm të zinxhirit të vlerës.

Si përfundim, ky studim synon të sjellë rekomandime që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe të suksesshëm të sektorit të verës në Kosovë, duke përmirësuar efikasitetin, cilësinë dhe konkurrencën e verës vendore në tregjet e brendshme dhe ndërkombëtare.

Fjalët kyçe: Vera, Fermeri, Konsumatori, Zinxhiri i vlerës.